



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2011/2012

## TESTI 2

# GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë më të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre, sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkohësh pjesët e përgjigjes, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.


Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se ta dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

**Të dëshirojmë sukses në provim!**



1.

### Luani dhe miu

Një herë duke fjetur, një luani i kaloi një mi nëpër gojë. Luani u zgjua dhe filloi të sillet nga të gjitha anët, për ta gjetur miun. Në atë çast e pa dhelpira dhe nisi ta qortojë, se si gjithë ai luan u tremb nga një mi i vogël. Kurse luani tha:


-Unë nuk u tremba po më kapi inati për guximin e tij.

(Ezopi)

Lexo tregimin e dhënë dhe thuaj se tregimet (Krijimet) e këtilla popullore ku si personazhe kryesore kemi kafshët, shpezët apo edhe insektet, e në të cilat alegoria është figura kryesore quhen:

- Përralla
- Anegdota
- Fabula
- Përrallëza?

2. Shiko me vëmendje tabelën e mëposhtme:



Ne tabele nënvizo kohën e kryer të tejskuar.

3.

Një klithmë u dëgjua.

Korbi krokati. E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë. Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan. Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë. Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte prerja e korbit. Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

(Anton Pashku “*Klithma*”)

Lexo tekstin e dhënë dhe trego cilit lloj të stilit i përkasin mjetet gjuhësore të përdorura nga autori:

- a) stilit letrar - artistik;
- b) stilit shkencor;
- c) stilit gazetaresk;
- d) stilit letrar.

4. Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe nënvizo fjalitë në të cilat jepet informacion për Shqipërinë dhe përshkruhet ajo.

Nuk do ta merrja këtë libër tepër seriozisht. Kjo nuk është një përpjekje për të zgjidhur një pe në një ballkanike; nuk është studim për popujt primitivë; nuk është kontribut për dijet njerëzore dhe shpresoj se asnjëri nuk do ta lexojë për ta përmirësuar trurin e vet. Kjo duhet të lexohet ashtu siç janë përjetuar aventurat në të, me një ngarendje të hareshme të mendjes, me një shije për popujt e huaj dhe shtigje të panjohura dhe me një kënaqësi për të papriturën. Këtu po u jap vetëm atë që kam parë, ndier dhe sidomos që kam mësuar në baritjet në mesin e fiseve në brendi të maleve veriore shqiptare. Madje, kjo nuk është as e tërë Shqipëria, ai vend i vogël, tepër i vogël edhe për ta gjetur edhe në hartë. Ky nuk është pos një fragment i kësaj bote të gjerë, tjetërfare dhe romantike, që ua sjell me vete një shtegtare atyre që rrinë në shtëpi.

R. W. L. (Rouz Uajlder Lein “*Majat e Shalës*”)

5. **Elefanti** është kafshë barngrënëse që jeton në Afrikë e Azi. Është kafsha më e madhe në tokë. Meshkujt elefantë janë të mëdhenj dhe mund të arrijnë me peshë gjer në 9071 kg. Ata kanë një hundë të gjatë me të cilën kryejnë një seri veprimesh. Elefanti konsiderohet si kafsha e katërt më e zgjuar në botë, pas shimpanzesë, balenës dhe delfinit. Elefanti me gjithë peshën e tij të rëndë mund të vrapojë me shpejtësi rreth 40 km/h duke ia kaluar edhe njeriut. Elefantët i tremben lepujve dhe qenve qofshin këta edhe te vegjël.

Lexo tekstin që ka të bëjë me elefantin dhe trego çfarë përfundime, qëndrime mund të nxjerrësh nga ky tekst? Ky tekst paraqet:

- a) Shpjegime për elefantët;
- b) Argumente për elefantët;
- c) Përshkrime për elefantët;



6. Hartoni një letër duke pasur parasysh rregullat të cilat duhet respektuar::

Shkruaj natyrshëm, sikur jeni duke folur me letërmarrësin.

I tregoni atij gjëra që ju interesojnë të dyve:

Mund të filloni duke iu përgjigjur pyetjeve që ju ka bërë në letrën që ju ka shkruar, ose duke bërë komente rreth asaj që ju ka treguar.

Më pas mund të jepni disa hollësira për vete, duke përdorur fjalët përshkruese.

Cilat rregulla duhet t'i keni parasysh kur të shkruaj ndonjë letër?

---



---



---



---



7. Pranë vizave shkruaj fjalët e mëposhtme sipas gjuhës letrare:

Amel\_\_\_\_\_ baj\_\_\_\_\_ dam\_\_\_\_\_

Syni\_\_\_\_\_ me punue\_\_\_\_\_ me kendue\_\_\_\_\_

Me lakue\_\_\_\_\_ pa mesue\_\_\_\_\_ kam lan\_\_\_\_\_

8. T Duke i vendosur në katrorët e mëposhtëm, tregoni cilat nga fjalët e dhëna shqiptohen dhe shkruhen me i dhe jo me y: ai, ay, *bilbil*, *bylbyl*, *fishek*, *fyshek*, *frikë*, *frykë*, *gjilpërë*, *gjylpërë*, *krimb*, *krymb* etj.

--	--	--	--	--	--

9. Lexo fjalitë e dhëna më poshtë dhe duke e rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë trego se cila prej fjalive të dhëna është shkruar sipas rregullave drejtshkrimore?

- a) Ana nuk e do salcën me perime;
- b) Familja nuk ka ushqim të mjaftueshëm;
- c) Ftohti ka ra heret në sabah.
- ç) Marimanga vajti musafire ke brumbulli.

10. Lexo fjalitë e dhëna dhe dallo cilat fjalë janë shkruar drejt sipas rregullave drejtëshkrimore. Në vizat përkatëse shkruaj ato.

- a) Aktyvitet jashtëshkollor. \_\_\_\_\_.
- b) Punojka akoma. \_\_\_\_\_.
- c) Ambijent i pastër. \_\_\_\_\_.
- d) Shkëmbyemje përvoje. \_\_\_\_\_.

**11.** Në vijën pas fjalëve shkruaj, cila është fonema që e kanë të gjitha këto fjalë.

uthull \_\_\_\_\_

fillon \_\_\_\_\_

llamba \_\_\_\_\_

**12.** Cilat janë dy fonemat që shërbejnë për të dalluar fjalët e mëposhtme të shënuara dhe trego se çfarë fonemash janë: zanore apo bashkëtingëllore?

vetull – petull: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

arë-urë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

gurë-murë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

pullë – pallë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

miell – diell: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

**13.** Renditi fjalët e fjalisë sipas llojit të tyre.

P.sh. ***Fëmijët luanin në oborr.***

Fëmijët ----- \_\_\_\_\_;

Luanin ----- \_\_\_\_\_;

Në ----- \_\_\_\_\_;

Oborr ----- \_\_\_\_\_;

**14.** Zanoret **e, ë, o** janë:

a) të mbyllura;

b) gjysmë të hapura;

c) të hapura;

d) të hapura të buzorëzuara.

**15.** Trego, duke nënvizuar brenda çdo fjale, ku bie theksi në fjalët e dhëna:

a) përpunim;

b) përsëri;

c) fletore;

ç) atdhetar.

**16.** Përballë titullit të veprave letrare shkruaj emrin e autorit të saj.

1. Hakmarrja -----/ / Vehbi Kikaj;
2. Rrethimi -----/ / Rrahman Dedaj;
3. Aventurat e Çipolinos -----/ / Tajar Hatipi;
4. Zogu e kulla -----/ / Xhani Rodari;
5. Sarajet e bardha -----/ / Jusuf Kelmendi

**17.** Lexo me kujdes vargjet e poezisë “Gjuha shqype” te Ndre Mjedjes dhe trego cilës gjini letrare i takon ajo:

### Gjuha Shqype

Permby za qe lshon bylbyli,  
gjuha shqipe m'shungullon;  
permby er' qe jep zymbyli,  
pa da zemren ma ngushllon.

Nder komb' tjera, nder dhena tjera,  
ku e shkoj jeten tash sa mot,  
vec per ty m'rreh zemra e mjera  
e prej mallit derdhi lot.

Nji kto gjuhe qe jam tue ndie,  
jan' te bukra me themel  
por prap' kjo, si diell pa hije,  
per mue t'tanave iu del.

- a) poezisë lirike;
- b) poezisë epike;
- c) poezisë dramatike;

Rretho shkronjën para përgjigjes se sakte.

18.

**Legjenda e Vilhem Teli**

Një mëngjes të shtune, një njeri i quajtur Vilhem Tel, po zbriste në tregun e qytetit. Ai jetonte larg, mes malesh. Me të ishte edhe i biri, Valteri. Teli ishte i njohur në të gjithë vendin për aftësitë e tij si harkëtar dhe për shpirtin e tij të pavarur. Atë ditë babë e bir nuk mendonin për gjë, por i kënaqeshin shoqërisë së njëri-tjetrit dhe bukurisë së fushave rreth e qark tyre. Vilhem Teli ecte me trupin drejt, ndërsa Valteri ecte krenar pranë të atit, i lumtur si gjithmonë që ishte me babanë e tij.

Kur kaluan pranë shtyllës, ushtarët vunë re se ata nuk u përkulën përpara kapelës së Geslerit.

Menjëherë ata e kapën Telin dhe djalin e tij dhe i çuan te komandanti i tyre.

Gesleri e pa Telin me qetësi. Ai kishte dëgjuar nga ushtarët dhe njerëzit për aftësitë dhe trimërinë e tij.

- Thonë se ti je një harkëtar i mirë, - i tha ai.

- Po, - tha Teli me krenari.

- Kam dëgjuar se ti mund të qëllosh çfarëdo lloj shenje,- vazhdoi Gesleri.

- Po, është e vërtetë,- tha Teli.

Gesleri e vështroi me një buzëqeshje të keqe.

- Atëherë ma provo këtë. Nëse je vërtetë aq i zoti, siç po thua, atëherë nuk do të të ndëshkoj për mungesën e respektit që tregove.

Ushtarët pritën të dëgjonin se çfarë do të urdhëronte Gesleri.

- Ejani pas meje! –urdhëroi ai. Ata iu drejtuan sheshit të qytetit. Një turmë e madhe njerëzish u mbledhën rreth e qark tyre. Të gjithë e donin Telin dhe po prisnin me ankth vendimin e Geslerit.

- Vilhem Teli do të fitojë lirinë e tij,- tha ai. Njerëzit e shikonin të heshtur.

- Djali yt do të qëndrojë aty, pranë pishës së madhe. Ti duhet të qëllosh me një shigjetë mollën që do të jetë mbi kokën e tij. Nëse fi ton, atëherë do të jesh i lirë.

Njerëzit u drodhën dhe tërhoqën fëmijët e tyre pranë vetes. Por Teli dhe djali i tij nuk dukeshin të trembur.

Lexo fragmentin e dhënë dhe trego se ky tekst është?

- a) monolog;
- b) dialog;
- c) përshkrim;
- d) legjendë.



19.

**Në ishuj**

Atë natë fjeta sipër shkëmbit, pasi kisha frikë prej tij. Në agim zbrita poshtë dhe e lashë derën hapur, me qëllim që ai të largohej. Por, kur u ktheva, ai ishte ende aty, i shtrirë në diell, me kokën midis putrave. Kisha kapur dy peshq që i gatova për drekë. Ai ishte ende shumë i dobët, prandaj i dhashë njërin prej tyre. Pasi e hëngri, u ngrit dhe erdhi pranë zjarrit, duke më vështruar me sytë e tij të verdhë që ishin shumë të ngushtë dhe të pjerrët te cepat.

Për katër net fjeta sipër shkëmbit. Çdo mëngjes e lija derën hapur, kështu që ai mund të largohej. Çdo ditë i jepja një peshk për të ngrënë dhe, sa herë që kthehesha në shtëpi, e gjeja gjithmonë pranë gardhit duke më pritur. Ai nuk e merrte peshkun nga dora ime, kështu që ia lija në tokë.

Një herë zgjata dorën drejt tij, por në këtë moment u zbraps dhe më tregoi dhëmbët.

Ditën e katërt, kur u ktheva në mëngjes nga shkëmbi, ku kalova natën, ai nuk ishte te gardhi duke më pritur. Një ndjenjë e çuditshme më pushtoi. Gjithmonë pata shpresuar se kur të kthehesha ai do të kishte shkuar. Por tani, ndërsa kaloja gardhin, befasisht u ndjeva keq.



Lexo fragmentin e dhënë dhe trego nëse teksti është:

- a) tregim;
- b) ritregim;
- c) analizë;

20.

### Vjeshta

U zhduk vapa, shkoi vera  
dhe bilbili më s'këndon.  
Erdhi vjeshta me të tjera,  
syri ynë i shikon.

Era fryn, fl etët bien.  
Pemët zhvishen si nga mot.  
Mali, fusha më s'ka hijen,  
që e kishin gjer më sot.

Po e mirë është vjeshta,  
sepse bujku gjith'punon  
Për të vjelur sot ka vreshtat  
Nesër arat po lëron

Njerëzit në çdo anë,  
porsa ngrihen në mëngjes.  
Nëpër fusha çdo gjë kanë,  
rendin mbledhin me kujdes.

Pra, me punë gjithë të rrojmë,  
se veç puna ne na vlen,  
sepse ndryshe s'trashëgojmë,  
verën tjetër që po vjen.

**Asdreni**

Lexo këtë poezi të Asdrenit dhe trego llojin e rimës të cilën e ka përdorur autori:

- a) aabb;
- b) abab;
- c) baba;
- d) baba.





# Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!  
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	